



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2232 Prot

Lezhë, më 22 / 2 /2023

VENDIM

Nr. 8, Datë 21 . 02 .2023

**“PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % PËR PERIUDHEN 01 – 31 JANAR 2023 ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes; të ligjit nr.139/ 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ , të nenit 21,të ligjit nr 57/2019, “Për asistencën në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597 dt.04. 09.2019 “Per përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKM nr.565 dt. 09. 08.2006 " Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike" i ndryshuar, VKM nr. 8 datë 14.01.2015 " Për mbrojtjen e shtresave në nevojë për heqjen e fashës deri 300 KWH në muaj", nga materiali i paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

**VENDOSI:**

Miratimin e listës se familjeve për t’u trajtuar me ndihmë ekonomike me anë të fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike për muajin **JANAR 2023**.

- Tabelë përmbledhese sipas Njesive Administrative për trajtimin me ndihmë ekonomike me anë të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% per muajin **JANAR 2023**.

Nr	Bashkia Lezhë/Njësitë	Nr. i familjeve	Masa e ndihmës 6%	Nr. i familjeve që përfitojnë kompensim	Masa e Kompensimit	Shkolla	Totali i Përfituar
1	LEZHË	22	89,353	6	7,728	1,800	98,881
2	SHENKOLL	25	114,344	14	18,032		132,376
3	KALLMET	3	14,036	3	3,864		17,900
4	ZEJMEN	6	22,966	4	5,152		28,118
5	BALLDREN	7	31,820	4	5,152	300	37,272
6	SHENGJIN	7	20,907	1	1,288		22,195
7	UNGREJ	5	20,039				20,039
8	DAJÇ	6	37,818				37,818
9	KOLSH	11	69,793	2	2,576	600	72,969
10	BLINISHT	2	11,066				11,066
	<b>TOTAL</b>	<b>94</b>	<b>432,142</b>	<b>34</b>	<b>43,792</b>	<b>2,700</b>	<b>478,634</b>

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

Bashkia Lezhë, Kodi Postar 4501, [florida.cunaj@lezha.gov.al](mailto:florida.cunaj@lezha.gov.al), web: [www.lezha.gov.al](http://www.lezha.gov.al)

KRYETARI  
NDUE LULI



1013

Prot 2232/  
Dt. 24.2.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 187/1 Prot.

Lezhë, më 24.02.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

Për Dijeni : **KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16, pika 2, gërma "b" të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", në ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në nenin 21, të ligjit nr.57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", si dhe VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 08, datë 21.02.2023, të Këshillit Bashkiak Lezhë "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 janar 2023".

**P R E F E K T I**

**Gjergj PRENDI**

